

20242544452

## LIGJ I REALIZIMIT TË BUXHETIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT PËR VITIN 2025

### 1. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

#### Neni 1

Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2025 ( në tekstin në vijim: Buxheti) realizohet sipas dispozitave të këtij ligji.

#### Neni 2

Shfrytëzuesit buxhetorë dhe shfrytëzuesit individualë obligohen që mjetet e përcaktuara në buxhet t'i shfrytëzojnë në mënyrë të destinuar, racionale, ekonomike dhe efikase.

### 2. REALIZIMI I BUXHETIT THEMELOR

#### Neni 3

Shfrytëzuesit buxhetorë të cilët në përbërjen e tyre kanë shfrytëzues individual janë të obliguar të kontrollojnë shfrytëzimin me dedikim dhe ligjor të mjeteve me të cilat disponojnë shfrytëzuesit individualë.

Shfrytëzuesit buxhetorë, të cilët në kuadër të buxhetit të tyre sigurojnë mjete për ndërmarrjet publike dhe shoqëritë tregtare shtetërore, janë të detyruar të kontrollojnë përdorimin e synuar dhe të ligjshëm të këtyre mjeteve.

#### Neni 4

Shfrytëzuesit buxhetorë dhe shfrytëzuesit individualë nuk guxojnë të ndërmarrin obligime ose të bëjnë shpenzime mbi limitin e mjeteve të aprovuara me Buxhetin.

#### Neni 5

Teknika e arkëtimit të të ardhurave, realizimi i shpenzimeve dhe menaxhimi i likuiditetit kryhet në pajtim me aktet e përcaktuara nga ministri i Financave.

#### Neni 6

Shfrytëzuesit buxhetorë të pushtetit qendror mund të shfrytëzojnë mjetet vetën nëse në afat prej 25 ditë nga dita e miratimit të Buxhetit në Thesarin e Ministrisë së Financave dorëzojnë plan financiar vjetor për tremujorët për shfrytëzimin e mjeteve sipas llogarive, programeve, nënprogrameve dhe zërave.

Shfrytëzuesit buxhetorë të pushtetit qendror të cilët në përbërjen e tyre kanë shfrytëzues individual janë të obliguar të secila shfrytëzues individual, në afat prej pesë ditë nga dita e miratimit të Buxhetit , të paraqesin ekstrakt të planit vjetor financiar me llogari, programe, nënprograme dhe zëra, në të cilin janë përfshirë mjetet e aprovuara për shfrytëzues individualë të caktuara.

Në bazë të ekstraktit sipas paragrafit 2 të këtij neni, shfrytëzuesit individualë përpilojnë planin e tyre financiar sipas tremujorëve, llogarive, programeve , nënprogrameve dhe zërave, të cilat kanë obligim të paraqesin te ministria përkatëse, ndërsa ministria kompetente planin financiar të konsoliduar e dorëzon te Ministria e Financave në afat prej 25 ditë nga dita e miratimit të Buxhetit.

Gjatë vitit, shfrytëzuesit buxhetorë të pushtetit qendror, mund të paraqesin kërkesa për ndryshimin e planit vjetor financiar sipas tremujorëve, për shfrytëzimin e mjeteve për llogari, programe, nënprograme dhe zëra, vetëm nëse bëhet fjalë për shpenzime të cilat nuk mund të planifikohen në kohë dhe për të njëjtën duhet të paraqitet arsyetim dhe plan vjetor financiar i rishikuar për tremujorë.

Në bazë të planit vjetor financiar, gjatë vitit, shfrytëzuesit buxhetor të pushtetit qendror përpilojnë propozim plan financiar për tremujor të caktuar, sipas muajit, llogarisë, programeve, nënprogrameve dhe zërave, të cilin e dorëzojnë në Thesarin e Ministrisë së Financave, më të së voni pesë ditë para fillimit të tremujorit për të cilin vlen plani, për shkak të aprovimit të tij.

Shfrytëzuesit buxhetor të pushtetit qendror të cilët në përbërjen e tyre kanë shfrytëzues individualë janë të obliguar në Thesarin pranë Ministrisë së Financave të paraqesin edhe plan përmbledhës tremujor, për muaj, llogari, programe, nënprograme dhe zëra për njësitë e saj shfrytëzuese.

Gjatë tremujorit të caktuar, shfrytëzuesit buxhetorë nga pushteti qendror mund të paraqesin kërkesë për ndryshimin e planit financiar tremujor sipas muajve, llogarive, programeve, nënprogrameve dhe zërave, brenda shumave të miratuara për tremujorin e caktuar.

Mjetet nga Buxheti themelor në Ndarjen 09002-Ministria e Financave - Funksionet e shtetit përdoren pa aprovimin e planit financiar.

Në rastin kur Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut aprovon mjete të Ndarjes 09002 - Ministria e Financave - Funksionet e shtetit të shfrytëzuesi tjetër buxhetor, mjetet aprovohen si plan financiar (e drejta e shpenzimit) në ndarjen për shfrytëzues buxhetorë.

#### Neni 7

Shfrytëzuesit buxhetorë nga pushteti qendror në tremujorin e parë të vitit aktual janë të detyruar të realizojnë së paku 15% të shpenzimeve kapitale të planifikuara nga buxheti bazë i miratuar, duke përfshirë edhe rishpërndarjen e mjeteve në zërat 480 - Blerja e pajisjeve dhe makinerive, 481 - Objekte ndërtimi, 482 - Objekte të tjera ndërtimi, 483 - Blerje mobiliesh dhe 486 - Blerje automjesh, në nënprogramet përkatëse në buxhetet e tyre, me përjashtim të Programit M - Integrimi në BE, Nënprogramit VA - Integrimin në NATO dhe Nënprogramit AA - Projektet infrastrukturore në komuna.

Shfrytëzuesit buxhetorë nga pushteti qendror në tremujorin e parë të vitit aktual janë të detyruar të realizojnë së paku 40% të shpenzimeve kapitale të planifikuara nga buxheti bazë i miratuar, duke përfshirë edhe rishpërndarjen e mjeteve në zërat 480 - Blerja e pajisjeve dhe makinerive, 481 - Objekte ndërtimi, 482 - Objekte të tjera ndërtimi, 483 - Blerje mobiljesh dhe 486 - Blerje automjesh, në nënprogramet përkatëse në buxhetet e tyre, me përjashtim të Programit M - Integrimi në BE, Nënprogramit VA - Integrimin në NATO dhe Nënprogramit AA - Projektet infrastrukturore në komuna.

Shfrytëzuesit buxhetorë nga pushteti qendror në tremujorin e parë të vitit aktual janë të detyruar të realizojnë së paku 65% të shpenzimeve kapitale të planifikuara nga buxheti bazë i miratuar, duke përfshirë edhe rishpërndarjen e mjeteve në zërat 480 - Blerja e pajisjeve dhe makinerive, 481 - Objekte ndërtimi, 482 - Objekte të tjera ndërtimi, 483 - Blerje mobiliesh dhe 486 - Blerje automjesh, në nënprogramet përkatëse në buxhetet e tyre, me përjashtim të Programit M - Integrimi në BE, Nënprogramit VA - Integrimin në NATO dhe Nënprogramit AA - Projektet infrastrukturore në komuna.

Nëse shfrytëzuesit buxhetorë nga pushteti qendror nuk veprojnë në pajtim me paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni, për mjetet e papërdorura deri në kufirin e përcaktuar (pjesa e mbetur deri në 15%, deri në 40%, d.m.th. deri në 65 %), Ministria e Financave kryen rishpërndarjen sipas detyrës zyrtare në zërin 414 – Rezerva për shpenzime kapitale brenda buxhetit të shfrytëzuesit buxhetor, pa të drejtë shpenzimi.

Nëse, nga tremujori i dytë i vitit aktual, shfrytëzuesit buxhetorë nga pushteti qendror kanë realizuar 40% të shpenzimeve kapitale në nivel të nënprogramit dhe zërit të buxhetit bazë të miratuar me rishpërndarjen e fondeve të përfshira, d.m.th. të tremujorit të tretë të vitit aktual kanë realizuar 65% të shpenzimeve kapitale të nivelit të nënprogramit dhe zërit nga buxheti bazë i miratuar me rishpërndarje të mjeteve, mjetet e rishpërndara sipas paragrafit 4 të këtij neni, Ministria e Financave, me detyrë zyrtare, i kthen ato në nënprogramin dhe artikullin përkatës nga ku janë rishpërndarë.

Nëse shfrytëzuesit buxhetorë nga pushteti qendror përfundimisht me 15 nëntor në vitin aktual kanë realizuar 70% të shpenzimeve kapitale në nivel të nënprogramit dhe zërit të buxhetit bazë të miratuar me rishpërndarjen e fondeve të përfshira, mjetet e rishpërndara sipas paragrafit 4 të këtij neni, Ministria e Financave, me detyrë zyrtare, i kthen ato në nënprogramin dhe artikullin përkatës nga ku janë rishpërndarë.

Obligimet e parapara në paragrafët 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të këtij neni nuk vlejnë për shfrytëzuesin buxhetor, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Me propozim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut vendos për shfrytëzimin e mjeteve nga zëri 414 - Rezerva për shpenzime kapitale, të cilat nuk janë kthyer në pajtim me paragrafin 5 të këtij neni me vendim për rishpërndarjen e mjeteve në mes të shfrytëzuesve buxhetorë dhe fondeve ose duke bërë ndryshime dhe plotësime në buxhet.

Nëse në afatet e parapara në paragrafët 2, 3 dhe 6 të këtij neni, përgatiten dhe miratohen ndryshimet dhe plotësimet në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin aktual, Ministria e Financave nuk vepron në pajtim me paragrafët 4, 5 dhe 6 të këtij neni.

Nëse në afatin e parapara në paragrafin 2 të këtij neni miratohen ndryshimet dhe plotësimet në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin aktual, Ministria e Financave nuk vepron në pajtim me paragrafin 4 të këtij neni.

#### Neni 8

Pagesën e pagave të shfrytëzuesve buxhetor nga pushteti qendror dhe të njëjstëve shfrytëzuesë e aprovon Ministria e Financave

Shfrytëzuesit buxhetorë të pushtetit qendror dhe shfrytëzuesit individualë obligohen dy ditë para pagesës së pagave, të Ministria e Financave të paraqesin kërkesë për aprovimin e mjeteve për paga ndaj të cilës do të paraqesin formularin F-1, për numrin e të punësuarve sipas emrit dhe mbiemrit, rrogës si dhe të dhëna të tjera të parashikuara në formularin në version të shkruar dhe elektronike për muajin në fjalë për të cilin vlen pagesa.

Në rast të punësimeve të reja, shfrytëzuesit buxhetor të pushtetit qendror dhe shfrytëzuesit individualë janë të obliguara të paraqesin njoftim për sigurimin e mjeteve financiare dhe të paraqesin formularin M-1.

Personi udhëheqës i shfrytëzuesit buxhetor dhe njësia shfrytëzues është përgjegjës se kërkesa e paraqitur për miratimin e mjeteve të pagave është në pajtim me ligjinin.

Formën dhe përmbajtjen e formularit F - 1 e përcakton ministri i Financave.

#### Neni 9

Punonjësit e shfrytëzuesve buxhetorë, shfrytëzuesit individualë dhe mjetet kanë të drejtë në shtesë pagash në masën deri në 30% të shumës së rrogës bazë për shkak të specifikës së punës dhe detyrave të punës dhe rritjes së ngarkesës së punës, nëse në buxhetin e shfrytëzuesit buxhetorë, shfrytëzuesit individualë dhe fondet janë mjete të parashikuara për këtë qëllim.

Kriteret më të afërta për realizimin e të drejtës për shtesë dhe për mënyrën e përcaktimit të lartësisë së shtesës sipas paragrafit (1) të këtij neni, me propozim të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Administratës Publike i përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

#### Neni 10

Punonjësit e shfrytëzuesve buxhetorë nga pushteti qendror që kryejnë punë të lidhura drejtpërdrejt me menaxhimin e instrumentit të ndihmës paraaderuese IPA në organet dhe strukturat e menaxhimit të instrumentit të ndihmës paraaderuese IPA kanë të drejtën e një shtesë pagash në lartësinë prej 15% të shumës së rrogës bazë, nëse me ligj tjetër nuk realizojnë të drejtën e shtesës së rrogës ose kompensimit të rrogës në bazë të kryerjes së punës dhe detyrave të punës në strukturat e menaxhimit të instrumentit të ndihmës para aderuese (IPA).

Punonjësit që kryejnë punë të lidhura drejtpërdrejt me menaxhimin e instrumentit të ndihmës paraaderuese IPA në shfrytëzuesin buxhetor përgjegjës për zbatimin e masave për pagesat direkte në bujqësi dhe zhvillimin rural dhe zbatimin e masave të ndihmës shtetërore në bujqësi, kanë të drejtë për shtesë të rrogës në masën 15% të shumës së rrogës bazë, nëse nuk e ushtrojnë të drejtën në shtesë të rrogës sipas paragrafit 1 të këtij neni.

#### Neni 11

Funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar të shfrytëzuesit buxhetorë dhe shfrytëzuesit individualë nga dita e emërimit të tyre, përfshirë ditën e shkarkimit të tyre, ju takon kompensim të shpenzimit për jetë të ndarë nga familja në lartësi prej 30% të neto rrogës mujore mesatare të paguar në Republikën e Maqedonisë së Veriut të paguar gjatë vitit të kaluar.

Jetë e ndarë nga familja konsiderohet kur personat sipas paragrafit 1 të këtij neni të cilët kanë familje për të mbajtur, themelojnë marrëdhënie pune në organ të administratës jashtë vendbanimit të tyre, ndërsa në vendin ku është selia e organit në të cilin kanë themeluar marrëdhënie pune nuk jetojnë me familjen e tyre.

Kompensim për shpenzimet për jetë të ndarë nuk ju takojnë personave sipas paragrafit 1 të këtij neni, nëse vendi i jetesës është më larg se 100 kilometra nga vendi i punës.

Personave të zgjedhur dhe emëruar të shfrytëzues buxhetor dhe njësitë e shfrytëzuesve të cilët përdorin kompensim për jetë të ndarë nga familja nuk ju takon kompensim për shpenzime për transport për shkak të vizitës së familjes më të ngushtë.

#### Neni 12

Personave që nuk ju takon e drejta për shfrytëzimin e banesës zyrtare në pajtim me ligjinin, nëse nuk mund t'u sigurohet, kanë të drejtë për kompensim për të marrë banesë me qira. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut do të përcaktojë lartësinë e kompensimit për marrjen e banesës me qira.

Kompensimi i shpenzimit për jetë të ndarë dhe kompensimi për banesë me qira, ndërmjet tyre janë përjashtues.

#### Neni 13

Dispozitat e neneve 11 dhe 12 të këtij ligji, zbatohen edhe për personat në shërbim në Armatën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në Ministrinë e Punëve të Brendshme, të cilëve ju takojnë këto të drejta në pajtim me ligjin.

#### Neni 14

Për ditët kur punonjësi është në udhëtim zyrtar, pushim mjekësor, pushim vjetor dhe në mungesë nga puna për ndonjë arsye tjetër, nuk paguhet kompensimi për jetën e ndarë.

#### Neni 15

Kompensimi për shpenzimet e shpërnguljes së personave që kanë të drejtën e përdorimit të banesës zyrtare paguhet në shumën e shpenzimeve faktike për transportin e sendeve shtëpiake.

Kompensimi i shpenzimeve të shpërnguljes nuk takon nëse punonjësit i paguhet një kompensim për jetë të ndarë.

#### Neni 16

Në rast të pushimit mjekësor të vazhdueshëm për më shumë se gjashtë muaj, punonjësit i paguhet një ndihmë financiare e njëhershme në lartësi të rrogës mesatare mujore neto të fundit të paguar në organin ku është i punësuar.

#### Neni 17

Në rast daljeje në pension, punonjësit i paguhet dyfishi i shumës së rrogës për largim nga puna, e llogaritur në bazë të rrogës mesatare mujore neto për punonjës në Republikë, e publikuar deri në ditën e pagesës.

#### Neni 18

Në rast të vdekjes së punonjësit, familjes së tij i takon ndihmë me para në lartësi të shumës së dyfishtë të rrogës mesatare mujore neto për punonjës në Republikë, e publikuar deri në ditën e pagesës.

Të punësuarit, në rast të vdekjes së një anëtari të familjes së ngushtë (prindi, bashkëshorti, fëmijët e lindur në martesë ose jashtë martese, njerka, fëmijët e birësuar dhe fëmijët e marrë për mirëmbajtje) ka të drejtë për ndihmë financiare në shumë të një rroge neto mesatare mujore për të punësuar në Republikë e publikuar deri në ditën e pagesës.

Kompensimet nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni paguhen pas kërkesës së parashtruar me dokumentacion të plotësuar në vitin e vdekjes, përkatësisht në vitin pasues të vitit të vdekjes.

Për punëtorët e angazhuar me kontrata për kalimin e punëtorit për punësime të përkohshme, mjetet për pagesën e ndihmës solide për punëtorët i siguron punëdhënësi, ndërsa pagesa bëhet nga Agjencia e Punësimeve të Përkohshme.

#### Neni 19

Shfrytëzuesit buxhetorë të drejtat e fituara në bazë të neneve 11, 12, 13, 15, 16, 17 dhe 18 të këtij ligji, i paguajnë nga mjetet e miratuara me Buxhetin.

#### Neni 20

Shfrytëzuesit buxhetorë dhe shfrytëzuesit individualë të mjeteve nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërmarrjet publike, agjencitë dhe personat juridikë publikë të themeluar nga pushteti qendror, si dhe shoqëritë tregtare të themeluara nga Republika e Maqedonisë së Veriut, përveç trupave rregullator të pavarur me autorizime publike të përcaktuara me ligj, mund të plotësojnë vendet e punës përmes procedurës për punësim për një kohë të caktuar, për një kohë të pacaktuar, avancim, transfer dhe të lidhin marrëveshje për transferimin e punëtorit për punësim të përkohshëm, për kryerjen e punës së përkohshme vetëm në kusht që për këtë të sigurohen mjete financiare në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, përkatësisht në planet financiare për vitin aktual fiskal.

Ministria e Financave në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për plotësimin e vendit të punës, me shkrim i njofton subjektet sipas paragrafit 1 të këtij neni për mjetet e siguruara financiare për plotësimin e vendit të punës përmes procedurës për punësim, avancim ose kalim mbi të punësuarit në institucionet e sektorit publik. Udhëheqësi i subjektit juridik është përgjegjës se për plotësimin e vendit të punës përmes procedurës për punësim ka siguar mjete financiare për vitin aktual.

Për plotësimin e vendit të punës përmes mobilitetit me procedurë për sistemim në korniza të shfrytëzuesit buxhetor ose përdoruesve individualë dhe për plotësimin e vendit të punës përmes mobilitetit me procedurë për marrjen ndërmjet përdoruesve individualë që janë në kompetencën e të njëjtit përdorues buxhetor, pëlqim jep udhëheqësi i shfrytëzuesit buxhetor, në bazë të mjeteve buxhetore të siguruara në tabelën e rogate.

Shfrytëzuesit buxhetorë dorëzojnë kërkesë për marrje të njoftimit nga Ministria e Financave për mjete financiare të siguruar për të plotësuar vendin e punës përmes punësimit për një periudhë të pacaktuar kohore në korniza të shfrytëzuesve individualë që janë në kompetencë të tyre pas analizës së kryer më parë për arsyetimin e kërkesës për punësim dhe vetëm nëse bëhet fjalë për një vend pune që është i nevojshëm për kryerjen e veprimtarisë bazë të shfrytëzuesit individual.

Gjatë dorëzimit të kërkesës për punësim në njësitë shfrytëzues, udhëheqësi i personit juridik paraqet Pasqyrë tabelare që përmban të dhëna për: numrin e të punësuarve deri më 31 dhjetor në tre vitet e fundit, mjetet e planifikuara në listën e rogate, mjetet e paguara nga masa e rogate, mjetet e paguara nga masa e rrogës deri në momentin e parashtrimit të kërkesës për punësim, mjetet e nevojshme për pagesën e rrogës deri në fund të vitit për të punësuarit ekzistues, mjetet e nevojshme për punësimet e perealizuara për të cilat është lëshuar njoftim paraprak për mjetet e siguruar financiare dhe mjetet e nevojshme për numrin e kërkuar të punësimeve të reja deri në fund të vitit. Udhëheqësi i subjektit juridik, në shtojcë të kërkesës dorëzon dhe nënshkruan deklaratë me të cilën vërteton se në korniza të masës së rogate janë siguruar mjete për punësimet e kërkuara.

Me rastin e paraqitjes së kërkesës sipas paragrafit 2 të këtij neni, për plotësimin e pozitës në ndërmarrjet publike, agjencitë dhe shoqëritë tregtare të themeluara nga Republika e Maqedonisë së Veriut, udhëheqësi i personit juridik dorëzon të dhëna financiare dhe të tjera për punësimin e kërkuar, si dhe deklaratën e nënshkruar të mjeteve të siguruar për realizimin e saj në planin financiar të personit juridik për vitin aktual, të miratuar nga organet kompetente në pajtim me ligjin.

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut për pëlqimin për mjetet e siguruar financiare vepron në pajtim me Ligjin për Kuvendin e Republikës së Maqedonisë.

Fondet janë të detyruara një herë në vit dhe me rastin e paraqitjes së kërkesës për punësim të bashkëngjisin pasqyrën tabelare të rrogës së fundit të paguar, e cila përmban të dhëna për numrin e të punësuarve ekzistues me emër dhe mbiemër, rrogën e paguar, shtesat dhe kompensime të rrogës.

Fondi i Sigurimit Shëndetësor është i detyruar që një herë në vit dhe me rastin e paraqitjes së kërkesës për punësim të bashkëngjisin pasqyrën tabelare të rrogës së fundit të paguar, e cila përmban të dhëna për numrin e të punësuarve ekzistues me emër dhe mbiemër, rrogën e paguar, shtesat dhe kompensime të rrogës.

#### Neni 21

Punëtorët në shfrytëzues buxhetorë dhe shfrytëzues individualë e ushtrojnë të drejtën e shtesës së rrogës për punën jashtë orarit, kryesisht përmes shfrytëzimit të orëve të lira, pra ditëve, aq sa janë punësuar për punë jashtë orarit të rregullt të punës, nëse buxheti i shfrytëzuesit buxhetor ose shfrytëzuesi individual nuk i sigurohen mjete për pagesën e shtesës së rrogës për punë jashtë orarit dhe shfrytëzimi i ditëve të lira për punëtorët nuk e prish procesin e rregullt të punës në kryerjen e detyrave të punës.

Mjetet e siguruar për këtë qëllim nënkuptojnë që shfrytëzuesit buxhetorë dhe shfrytëzuesit individualë nuk duhet të paraqesin kërkesë për pagesën e rrogës që do të jetë më e madhe se e drejta e përcaktuar mujore për pagesën e rogate, përkatësisht nga mjetet e parashikuara buxhetore në grupin e rogate.

## 2.1 REALIZIMI I SHPENZIMEVE TË VEÇANTA TË PËRCAKTUARA NË BUXHETIN BAZË

### Neni 22

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 04001 - Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Nënprogrami 16 - Përkrahja për shtypjen dhe shpërndarjen e mediave të shkruara, përdoren sipas programit të miratuar më parë nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të Sekretariati të Përgjithshëm të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

### Neni 23

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 04002 - Shërbimi i Punëve të Përgjithshme dhe të Përbashkëta të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Nënprogrami 1A - Rindërtimi i objekteve të organeve qeveritare, përdoren sipas një programi të miratuar më parë nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut me propozim të Shërbimit të Punëve të Përgjithshme dhe të Përbashkëta të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 04002 – Shërbimi i Punëve të Përgjithshme dhe të Përbashkëta të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Nënprogrami 10 – Administrata, zëri 461 – Subvencionet për ndërmarrjet publike, përdoren me vendim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut me propozim të Shërbimit të Punëve të Përgjithshme dhe të Përbashkëta të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

### Neni 24

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 04010 - Ministria e Marrëdhënieve Ndërmjet Bashkësive, Nënprogrami 11 - Promovimi i marrëdhënieve ndëretnike, pika 463 - Transferet për organizatat joqeveritare që kanë për qëllim financimin e aktiviteteve programore të shoqatave të qytetarëve dhe fondacioneve, do të përdoren. në bazë të vendimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të Ministrisë për marrëdhënie ndërmjet bashkësive.

Shoqatat dhe fondacionet për Ministrinë e Marrëdhënieve Ndërmjet Bashkësive dorëzojnë programe për qëllimin e mjeteve të kërkuara, pas konkursit të shpallur më parë.

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 04010 - Ministria e Marrëdhënieve ndërmjet Bashkësive, Nënprogrami 12 - Përkujtimi i përvjetorit të Marrëveshjes kornizë, pika 425 - Shërbimet kontraktuale, shfrytëzohen sipas programit të miratuar më parë nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të Ministrisë së Marrëdhënieve Ndërmjet Bashkësive.

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 04010 - Ministria e Marrëdhënieve ndërmjet Bashkësive, Nënprogrami 16 - Përkujtimi i përvjetorit të Marrëveshjes kornizë, pika 425 - Shërbimet kontraktuale, shfrytëzohen sipas programit të miratuar më parë nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të Ministrisë së Marrëdhënieve Ndërmjet Bashkësive.

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 04010 - Ministria e Marrëdhënieve ndërmjet Bashkësive, Nën-Programi K5 - Përfaqësimi adekuat dhe i drejtë i bashkësive, do të përdoren për punësimin e pjesëtarëve të bashkësive në mesin e përfituesve buxhetorë dhe përfituesve individualë nga qeveria qendrore, pasi paraprakisht miratimin e Trupit Koordinues për përfaqësim adekuat dhe të drejtë, të themeluar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

### Neni 25

Në ndarjen 07001 – Ministria e Drejtësisë, Nënprogrami 11 – Këshilli Nacional për Ndërmjetësim, sigurohen mjete për Këshillin Nacional për Ndërmjetësim.

#### Neni 26

Në Ndarjen 09001 – Ministria e Financave, Nënprogrami 11 – Denacionalizimi, pika 425 – Shërbimet kontraktuese, parashikohen mjete për pagesën e shpenzimeve dhe tarifave për Komisionet për denacionalizim.

#### Neni 27

Në Ndarjen 09002 - Ministria e Financave - Funkcionet e Shtetit, Nënprogrami 20 - Funkcionet, zëri 426 - Shpenzime të tjera rrjedhëse, sigurohen mjete për pagesën e provizioneve për qarkullimin pagesor, për shërbimet e kryera dhe për shpenzime të tjera.

#### Neni 28

Mjetet e përcaktuara në seksionin 09002 - Ministria e Financave - Funkcionet e Shtetit, nënprogrami 20 - Funkcionet, kategoritë 45 - Pagesat e interesit dhe 49 - Shlyerja e kryegjësë dhe e daljes, për shlyerjen e interesit dhe kryegjësë në bazë të borxhit të jashtëm dhe të brendshëm, si dhe mjetet e përcaktuara në nënprogramin 20 – Funkcionet, zëri 466 – Pagesat për garanci, zëri 485 – Investimet dhe mjetet jofinanciare dhe zëri 495 – Daljet për garanci, përdoren për të paguar garancitë e shtetit në përputhje me dispozitat e marrëveshjeve të lidhura, si dhe kreditë afatshkurtra, të cilat kthehen deri në fund të vitit fiskal, realizohen pavarësisht nga alokimi i planifikuar buxhetor për këtë dedikim.

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 09002 - Ministria e Financave - Funkcionet e shtetit, nënprogrami 20 - Funkcionet, zëri 494 - Dalja sipas huave të dhëna ndaj institucioneve, përdoren në bazë të vendimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të Ministrisë së Financave.

#### Neni 29

Mjetet për financimin e projekteve nga komponentët individualë të IPA-s (bashkëfinancimi nacional dhe fondet IPA nga BE) janë planifikuar indikativisht në seksionin 09002 - Ministria e Financave - Funkcionet e Shtetit, përveç fondeve për bashkëfinancim kombëtar nga IPA - Zhvillimi Rural i cili është planifikuar në nenin 14004 – Agjencia për Mbështetje Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe Seksioni 14001 – Ministria e Bujqësisë, e Pylltarisë dhe e Ekonomisë së Ujërave.

Në rast të transferimit të parakohshëm të mjeteve nga BE-ja të dedikuara për financimin e projekteve nga komponentët të caktuar të IPA-së, mjetet do të sigurohen nga Buxheti, në pajtim me procedurat e brendshme të Ministrisë së Financave.

Gjatë realizimit, prioritet në pagesën e mjeteve do të jetë financimi i projekteve nga komponentët të caktuar të IPA-s.

#### Neni 30

Në Ndarja 09002 Ministria e Financave- Funkcionet e Shtetit Nënprogrami 20- Funksione, zëri 465 Pagesa për dokumentet e lëshuara, sigurohen mjete për pagesa për dokumente ekzekutive në rast kur është debitor Republika e Maqedonisë. Këto mjete realizohen pavarësisht nga ndarja e planifikuar buxhetore për këtë qëllim.

#### Neni 31

Në Ndarja 09002 Ministria E Financave - Funkcionet e Shtetit, Nënprogrami 20- Funksione, zëri 480 Blerja e pajisjes dhe makinave, sigurohen dhe mjete për kthimin e tatimit e vlerës së shtuar gjatë realizimit të donacionit në interes publik, si dhe mjeteve për kthimin e tatimit mbi vlerën e shtuar dhe akcizës për realizimin e projekteve të bazuara në marrëveshjet ndërmjet



Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe donatorëve të huaj, në të cilat ekziston një klauzolë që fondet e dhuruara nuk mund të përdoren për të paguar taksat. Këto mjete realizohen pavarësisht nga ndarja e planifikuar buxhetore për këtë qëllim.

Rregullat më të afërta për mënyrën e zbatimit të dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni i miraton ministri i Financave.

#### Neni 32

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 09002 MINISTRIA E FINANCAVE - FUNKSIONET E SHTETIT, Nënprogrami AO DECENTRALIZIMI, zëri 441 Dotacione nga TVSH, barten në llogaritë e komunave me vendim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

#### Neni 33

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 10101 - Ministria e Energjetikës, e Minierave dhe e Lëndëve të Para Minerale, Nënprogrami 3D - Gasifikimi, zëri 464 - Transferet e ndryshme, shfrytëzohen në bazë të vendimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të Ministrisë së Energjetikës, të Minierave dhe të Lëndëve të Para Minerale.

#### Neni 34

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 12101 - Ministria e Mjedisit Jetësor dhe e Planifikimit Hapësinor, Nënprogrami AA - Projektet e infrastrukturës në komuna, zëri 488 - Dotacionet kapitale për NJVL-të, përdoren në bazë të vendimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut me propozim të ministria kompetente në bashkëpunim me Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale. Mjetet përdoren në bazë të kriterëve dhe procedurave të përcaktuara për shpërndarjen e dotacioneve kapitale nga ministria kompetente, kurse pagesa e mjeteve bëhet në bazë të punëve të kryera dhe dokumentacionit të plotë të pagesës.

#### Neni 35

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 13001 - Ministria e Transportit, Nënprogrami 11 - Mbështetja për zbatimin e Dekadës dhe Strategjisë për Romët, zëri 488 - Dotacione kapitale për NJVL-të, përdoren sipas programit të miratuar më parë nga Qeveria e Republikës Maqedonisë së Veriut, me propozim të Ministrisë së Transportit.

Ndarjen e mjeteve sipas paragrafit 1 të këtij neni e bën Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut me vendim, me propozim të Ministrisë së Transportit.

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 13001 - Ministria e Transportit, Nënprogrami 20 - trafik dhe komunikacion, zëri 464 - Dotacione kapitale për NJVL-të, përdoren sipas programit të miratuar më parë nga Qeveria e Republikës Maqedonisë së Veriut, me propozim të Ministrisë së Transportit.

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 13001 - Ministria e Transportit, Nënprogrami 2M- investime në rrugën infrastruktore, zëri 489 - Subvencione kapitale për ndërmarrje dhe organizata joqeveritare, përdoren sipas programit të miratuar më parë nga Qeveria e Republikës Maqedonisë së Veriut, me propozim të Ministrisë së Transportit.

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 13001 - Ministria e Transportit, Nënprogrami 30 - Urbanizëm dhe ndërtimtari, zëri 482 - Objekte të tjera ndërtimore, përdoren sipas programit të miratuar më parë nga Ministria e Transportit.

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 13001 - Ministria e Mjedisit Jetësor dhe e Planifikimit Hapësinor, Nënprogrami AA - Projektet e infrastrukturës në komuna, zëri 488 - Dotacionet kapitale për NJVL-të, përdoren në bazë të vendimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut me propozim të ministria kompetente në bashkëpunim me Ministrinë e Vetëqeverisjes

